



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 20
16.12.2019

NR. VENDIMI 15
18.12.2019

V E N D I M
“PËR SHUARJEN E MASËS SË SEKUESTRIMIN TË PASURISË”

Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, e përbërë nga :

Gjyqtar : Klodian KURUSHI

Asistuar prej sekretares gjyqësore **Ermira Kthupi**, sot më datë 18. 12. 2019, zhvilloi gjykimin e kërkesës penale që i përket;

KËRKUES : Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë “Për Krime të Rënda” Tiranë, përfaqesuar nga **prokuroria D. M.**

KUNDER : **1.I.M.**, i biri i S. dhe i F., i datëlindjes xx.xx.xxxx, lindur dhe banues në Vore, Tiranë. Zhvilluar gjykimi në mungesë të tij.

2.H.R., i biri i B. dhe i S., i datëlindjes xx.xx.xxxx, lindur dhe banues në Bërxullë, Tiranë. Zhvilluar gjykimi në mungesë të tij.

OBJEKTI : 1. Pushimin e procedimit pasuror regjistruar në Prokurori me nr. 03/2014.
2. Revokimin e Sekuestrimit të pasurive të luajtshme të shtetasve I.M. dhe H.R. të vendosur me vendimin nr. 07. datë 30. 04. 2014 të dhënë nga Gjykata e shkallës së parë “Për Krimet e Rënda” Tiranë për pasuritë e poshtme:

- a) Nje shume monetare prej 501.500 leke, qe ndodhet ne Banken Intesa San Paolo Group, ne llogarine me nr. 2014730712.
- b) Nje shume monetare ne euro prej 11.150, qe ndodhet ne Banken Intesa San Paolo Group, ne llogarine me nr. 2021930701.
- c) Nje automjet i tipit B.M.W. X6 me ngjyre te zeze, me targa xxxxxx, se bashku me celesat.

d) Nje automjet i tipit Renault Clio, me ngjyre te gri, me targa xxxxxx, se bashku me celesat.

BAZA LIGJORE: Nenet 3, 24/2 të Ligji nr. 10192 datë 03. 12. 2009 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”.

Gjykata pasi shqyrtoi çështjen, adminstroi provat, dëgjoi në diskutimin përfundimtar prokurorin e cili kërkoi:

-Pranimin e kërkesave sipas objektit

V Ë R E N

Rrethanat e faktit

Prokuroria per Krime te Renda Tirane me date 28. 04. 2014 ka regjistruar procedimin pasuror nr. 03 te vitit 2014 ne ngarkim te shtetasve I.M. dhe H.R..

Ne ngarkim te ketyre shtetasve me date 28. 01. 2014 nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësore Tiranë, ka filluar procedimi penal nr. 724, i vitit 2014, pasi dyshohen te kene kryer vepren penale të “Prodhimit dhe shitjes se narkotikeve” në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283/2 i K. Penal.

Më datë 26. 01. 2014, janë arrestuar në flagrancë shtetasit I.M. dhe H.R., pasi atyre u është gjetur dhe sekuestruar në cilesinë e provës materiale një sasi lënde narkotike e llojit kokainë me peshë 1018 gram. Shtetasit I.M. i janë gjetur dhe sekuestruar në funksion të procedimit penal një shumë monetare prej 501.500 lekë llogari bankare, një shumë në euro prej 11.150 llogari bankare, një automjet e tipit B.M.W. X6, me ngjyre të zezë, me targa xxxxxxxx, së bashku me celësat. Shtetasit H.R. i janë gjetur dhe sekuestruar një automjet tip Renault Clio, me ngjyrë gri me targa xxxxxx, së bashku me celësat.

Mbi bazën e kërkesës së paraqitur nga Prokuroria “Për Krimet e Rënda” Tiranë, gjykata me vendimin e saj nr. 07 datë 30. 04. 2014 ka vendosur:

- Sekuestrimin e pasurive tw shtetasve I.M. dhe H.R. si më poshtw:
 - a) Një shumë monetare prej 501 500 (pesëqind e një mijë e pesëqind) lekë që ndodhet në Banken Intesa San Paolo Group, në llogarinë me nr. 2014730712.
 - b) Një shume monetare në euro prej 11 150 (njëmbëdhjetë mijë e njëqind e pesëdhjetë) që ndodhet në

Bankën Intesa San Paolo Group, në llogarinë me nr. 2021930701.

c) Nje automjet i tipit B.M.W. X6 me ngjyrë te zezë, me targa xxxxxxxx, së bashku me çelesat, që ndodhet në ambientet e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë.

d) Nje automjet i tipit Renault Clio me ngjyrë gri, me targa xxxxxxxx, së bashku me çelesat që ndodhet në ambientet e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë.

f) Per Administrimin e kesaj e pasurie të ngarkohet z. Kleant Xholi, i cili është administrator pranë Agjencisë për Administrimin e pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë.

g) Për ekzekutimin e këtij vendimi të ngarkohet Zyra e Përmbartimit Tiranë.

Në arsyetimin e këtij vendim gjykata në mënyrë specifike është shprehur se:

“Sendet e kërkuara për sekuestrim janë gjithashtu të sekuestruara nga Prokuroria e rrethit gjyqësor Tiranë për llogari të procedimit penal të nisur prej saj ndaj të dy personave. Bazuar në nenin në nenin 5/3 të ligjit 10 192 datë 03. 12. 2009 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimin të Organizuar dhe Trafikimit nëpërmjet Masa Parandaluese kundër Pasurisë” **gjykata urdhëron pezullimin e pasojave të zbatimit të masës së sekuestrimit për sa kohë këto sende qëndrojnë të sekuestruara me një vendim të marrë për llogari të një procedimi penal të nisur nga Prokuroria e rrethit gjyqësor Tiranë. Nëse në të ardhmen gjykata penale do të marrë një vendim penal për revokimin apo shuarjen e masave të sekuestrimit atëherë pezullimi i masës së sekuestrimit i dhënë në këtë vendim civil përfundon dhe sekuestrimi i sendeve rivendoset menjëherë sipas këtij vendimi”.**

Më tej shtetasit H.R.dhe I.M. janë gjykuar nga gjykata e shkallës së parë Tiranë dhe dënuar respektivisht për veprat penale të “*Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve*” parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal dhe “*Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik*” parashikuar nga neni 236/2 i Kodit Penal. Vendimi i dënimit i dhënë nga gjykata e shkallës së parë Tiranë ndaj dy personave të mësipërm mban nr. 2520 dhe është shpallur më datë 29. 10. 2014. Në këtë vendim ndër të tjera gjykata e shkallës së parë Tiranë në procesin penal ka disponuar me kthimin e të gjitha sendeve të sekuestruara të përmendura më lart tek të pandehurit e mësipërm.

Ky vendim i dhënë nga gjykata e shkallës së parë Tiranë është lënë në fuqi me vendimin nr. 589 datë 26. 03. 2015 nga gjykata e Apelit Tiranë.

Më tej prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë me urdhrin e ekzekutimit për vendimin penal nr. 2520 datë 29. 10. 2014 të gjykatës së shkallës së parë Tiranë ka vendosur që të gjitha provat materiale të sekuestruara në kuadër të procedimit penal por të disponuar nga gjykata e shkallës së parë Tiranë në favor të shtetasve H.R. dhe I.M. t’ u kthehen këtyre të fundit.

Më tej rezulton se të gjitha provat materiale të përmendura më lart të sekuestruara në kuadër të procedimit penal u janë kthyer personave të mësipër.

Të gjitha këto sende kanë qenë të sekuestruara edhe në kuadër të procedimit pasuror me

Ligjin Parandalues për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive. Në dispozitivin e këtij vendimi gjykata e shkallës së parë “Për Krimet e Rënda” Tiranë ka urdhëruar zyrën e përmbartimit Tiranë për ekzekutimin e këtij vendimi. Siç rezulton nga aktet e dosjes asnjëherë Zyra e Përmbartimit Tiranë nuk e ka ekzekutuar vendimin e sekuestrimit të pasurive të dhënë nga Gjykata e shkallës së parë “Për Krimet e Rënda” Tiranë, ndonëse në këtë vendimi është urdhëruar në mënyrë të qartë se:

“...Nëse në të ardhmen gjykata penale do të marrë një vendim penal për revokimin apo shuarjen e masave të sekuestrimit atëherë pezullimi i masës së sekuestrimit i dhënë në këtë vendim civil përfundon dhe sekuestrimi i sendeve rivendoset menjëherë sipas këtij vendimi.

Zyra e Përmbartimit Tiranë me vendimin e saj nr. 8677 Prot. datë 16. 10. 2017 ka pushuar urdhrin e ekzekutimit (Vendimin) nr. 07 datë 30. 04. 2014 të Gjykatës së shkallës së parë “Për Krimet e Rënda” Tiranë me argumentin se:

Në vendimin e gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 2520 datë 29. 10. 2014 sendet e luajtshme të sekuestruara u janë kthyer qytetarëve bazuar në urdhrin e ekzekutimit të vendimit penal datë 17. 04. 2015 bazuar në shkresën nr. 2556/1 prot datë 11. 10. 2017 të Prokurorisë së Përgjithshme...”

Kërkesa e prokurorisë

Prokuroria “Për Krimet e Rënda” Tiranë i është drejtuar Gjykatës së shkallës së parë “Për Krimet e Rënda” Tiranë me kërkesën për pushimin e procedimit pasuror si dhe me kërkesën për revokimin e masës së sekuestrimit të vendosur nga kjo gjykatë me vendimin e saj nr. 07 datë 30. 04. 2014.

Në këtë kërkim prokuroria mbështet qëndrimin e saj në argumentin se hetimi pasuror në thelb ka mbetur pa objekt pasi pasuritë u janë kthyer pronarëve të tyre.

Ligji i zbatueshëm

LIGJ Nr. 10 192, datë 3.12.2009 “PËR PARANDALIMIN DHE GODITJEN E KRIMIT TË ORGANIZUAR, TRAFIKIMIT, KORRUPSIONIT DHE KRIMEVE TË TJERA NËPËRMJET MASAVE PARANDALUESE KUNDËR PASURISË”

(ndryshuar me ligjin nr. 24/2014, datë 20.3.2014, nr. 70/2017, datë 27.4.2017)

Neni 12

Procedura e sekuestrimit

(ndryshuar me ligjin nr. 70/2017, datë 27.4.2017)

1. Kërkesa për sekuestrimin e pasurisë shqyrtohet nga gjykata në dhomën e këshillimit, brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes, në bazë të dokumenteve dhe akteve të paraqitura nga prokurori.
2. Vendimi për masën e sekuestrimit është i ekzekutueshëm me shpalljen e tij. Masa e sekuestrimit është e vlefshme për një periudhë gjashtëmujore, duke filluar nga momenti i zbatimit të saj.
3. Në rastin e verifikimeve komplekse, me kërkesë të prokurorit ose kryesisht, gjykata mund të vendosë zgjatjen e afatit të zbatimit të masës së sekuestrimit për periudha gjashtëmujore, por jo më shumë se dy vjet nga data e fillimit të afatit të caktuar sipas pikës 2 të këtij neni. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatën e apelit, e cila vendos brenda 15 ditëve nga marrja e akteve.
4. Jo më vonë se 5 ditë përpara mbarimit të afatit kohor të masës së sekuestrimit, të parashikuar në pikën 2 ose

3, të këtij neni, gjykata cakton një seancë të posaçme, duke njoftuar prokurorin, personat e përmendur në nenin 3, pikat 1 dhe 2, të këtij ligji, si dhe mbrojtësin e zgjedhur. Kërkesa e prokurorit për revokimin e sekuestrimit nuk e pengon gjykatën të vendosë konfiskimin e pasurisë kur ajo çmon se plotësohen kriteret e parashikuara në këtë ligj.

5. Kur seanca e posaçme, sipas pikës 4, të këtij neni, nuk caktohet, gjykata, me kërkesë të palëve ose kryesisht, konstaton shuarjen e masës së sekuestrimit. Shuarja e masës së sekuestrimit nuk pengon paraqitjen dhe pranimin e një kërkesë të re për konfiskimin e pasurisë.

Dispozitë kalimtare

(vendosur me ligjin nr. 70/2017, datë 27.4.2017)

1. Ky ligj zbatohet për kërkesat e marrjes së masave parandaluese të paraqitura nga prokurori në gjykatën kompetente pas hyrjes në fuqi të tij. 16

2. Për procedimet pasurore në fazën e hetimit, ky ligj fillon të zbatohet me hyrjen e tij në fuqi.

Vlerësimi i Gjykatës

Gjykata fillimisht përcakton qasjen e saj në lidhje me ligjin e zbatueshëm në rastin konkret, për shkak se masa e sekuestrimit është vendosur ndaj pasurive referuar të njëjtit ligj por para ndryshimeve të fundit që ai ka pësuar në vitin 2017. Gjykata vlerëson të ndalet në çështjen e përzgjedhjes së ligjit të zbatueshëm për shkak të kërkesës së prokurorisë për revokimin e masës së sekuestrimit referuar ligjit në fuqi, ndërkohë që vetë masa e sekuestrimit është vendosur me Ligjin Nr. 10 192, datë 3.12.2009, para ndryshimeve të fundit të bëra në vitin 2017. Përzgjedhja e ligjit të zbatueshëm në këtë rast paraqet rëndësi për shkak të normës konkrete që duhet të zbatohet për çështjen në shqyrtim.

Gjykata vlerësoi rastin e urgjencës në trajtimin e kësaj çështjeje për shkak të afateve kohore të kohëzgjatjes të masës së sekuestrimit të vendosur me vendim nga gjykata e shkallës së parë “Për Krimet e Rënda” Tiranë datë 30. 04. 2014. Në thelb referuar nenit 12 të Ligjit masa e sekuestrimit është e vlefshme për një periudhë prej 6 muajsh. Ajo mund të zgjatet me kërkesë të prokurorit ose kryesisht nga gjykata për periudha 6 mujore por jo më shumë se 2 vjet nga dita e zbatimit të saj.

Në rastin në gjykim, pas lëshimit të urdhrimit të prokurorit pranë gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë më datë 17. 04. 2015 që kishte për objekt kthimin e sendeve të sekuestruara me vendimin penal, për shkak të moskoordinimit të veprimeve të Prokurorisë Tiranë në bashkëpunim me Prokurorinë “Për Krimet e Rënda” Tiranë dhe Zyrës së Përmbarrimit Tiranë, ndaj pasurive që u disponua me kthimin e tyre duhej të kishte filluar zbatimin e efekteve të sekuestrimit të vendimit të gjykatës së shkallës së parë “Për Krimet e Rënda” Tiranë.

Pra në përfundim të të gjitha veprimeve procedurale, Zyra e Përmbarrimit Tiranë pasi të ishte njoftuar nga prokuroria për revokimin e masës së sekuestrimit të vendosur për shkak të procedimit penal, duhej të rivendoste masën e sekuestrimit për të njëjtat pasuri të cilat ishin të përcaktuara në vendimin e sekuestrimit parandalues të dhënë nga gjykata e shkallës së parë “Për Krimet e Rënda” Tiranë. Ky veprim nuk është kryer nga Përmbarruesi i cili duhet të ishte

i njoftuar nga Prokuroria e rrethit gjyqësor Tiranë në koordinim edhe me Prokurorinë “Për Krimet e Rënda” Tiranë.

Kështu që masa e sekuestros parandaluese që është vendosur nga Gjykata e shkallës së parë “Për Krimet e Rënda” Tiranë i ka humbur efektet e saj pasi kanë kaluar më shumë se 5 (pesë) vjet nga dita kur kjo masë është caktuar dhe ka mbetur e paekzekutuar. Në këtë kuptim për shkak të kthimit të sendeve të sekuestruara me vendimin penal tek pronarët e tyre masa e sekuestros parandaluese ka mbetur pa objekt për shkak të kalimit të afatit 5 vjeçar dhe si e tillë ajo është e shuar, bazuar në nenin 12/5 e këtij ligji.

Konstatimi i shuarjes së masës së sekuestrimit të pasurive të sekuestruara më parë nga gjykata e shkallës së parë “Për Krimet e Rënda” Tiranë ka efektet deklarativ, për shkak se këto pasuri janë kthyer më parë me vendimin penal të dhënë nga gjykata e shkallës së parë Tiranë. Kështu që efekti deklarativ i shuarjes së masës së sekuestros shqyrtohet kryesisht nga gjykata e “Për Krimet e Rënda” Tiranë referuar nenin 12/5 të këtij ligji pa qenë e nevojshme të njoftohen palët në proces.

Gjithësesi konstatimi i shuarjes së masës së sekuestros nuk e pengon prokurorinë që të zhvillojë të gjitha verifikimet e nevojshme në lidhje me pasuritë e sekuestruara më parë nga gjykata dhe nëse më pas vlerëson se këto pasuri duhet ti nënshtrohen procesit gjyqësor të konfiskimit, mund të paraqes përpara gjykatës kërkesën për konfiskimin tërësor ose pjesor të këtyre pasurive.

Kërkesa e prokurorisë për pushimin e procedimit pasuror në gjykatë nuk gjen referencë ligjore në Ligjin Nr. 10 192, datë 3.12.2009 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar, Trafikimit, Korrupsionit dhe Krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese Kundër Pasurisë (ndryshuar me ligjin nr. 24/2014, datë 20.3.2014, nr. 70/2017, datë 27.4.2017). Si e tillë kjo kërkesë nuk pranohet nga gjykata.

Edhe kërkesa për revokimin e masës së sekuestros, është një kërkesë e pa mbështetur në ligj. Referuar nenin 12/b – 2 të Ligjit “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar, Trafikimit, Korrupsionit dhe Krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese Kundër Pasurisë” revokimi i masës së sekuestros mund të vendoset nga gjykata kur pasuria e sekuestruar zëvendësohet me pasuri të barasvelfshme dhe ky zëvendësim çmohet i përshtatshëm nga gjykata.

Pra kriteret ligjore të revokimit të masës së sekuestros të parashkikuar nga kjo dispozitë nuk kanë asnjë lidhje faktike më rastin e marrë në shqyrtim. Rrjedhimisht edhe kjo kërkesë e prokurorisë nuk pranohet nga gjykata për shkak të mos mbështetjes ligjore të saj.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata bazuar në nenet 12, 12/b, e vijues të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe Goditjen e Krimet të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”,

VENDOSI

- Konstatimin e shuarjes së masës së sekuestros vendosur nga gjykata e shkallës së parë “Për Krimet e Rënda” Tiranë me vendimin e saj nr. 07 datë 30. 04. 2014 ndaj pasurive te shtetasve I.M. dhe H.R. si më poshtme:
 - a) Një shumë monetare prej 501 500 (pesëqind e një mijë e pesëqind) lekë që ndodhet në Banken Intesa San Paolo Group, në llogarinë me nr. 2014730712.
 - b) Një shume monetare në euro prej 11 150 (njëmbëdhjetë mijë e njëqind e pesëdhjetë) që ndodhet në Bankën Intesa San Paolo Group, në llogarinë me nr. 2021930701.
 - c) Nje automjet i tipit B.M.W X6 me ngjyrë te zezë, me targa xxxxxxxx, së bashku me çelesat.
 - d) Nje automjet i tipit Renault Clio me ngjyrë gri, me targa xxxxxxxx, së bashku me çelesat.
- Mos pranimin e kërkesës për pushimin e procedimit pasuror nr. 03/2014 të paraqitur nga Prokuroria “Për Krimet e Rënda” Tiranë.
- Mos pranimin e kërkesës për revokimin e sekuestros vendosur me vendimin nr. 07 datë 30. 04. 2014 të gjykatës së shkallës së parë “Për Krimet e Rënda” Tiranë si të pambështetur në ligj.
- Kundër vendimit lejohet ankim në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda brenda 15 ditëve filluar ky afat nga e nesërmja e shpalljes së tij për palën e pranishme, ndërsa për palët në mungese, ky afat fillon nga dita e marrjes dijeni për vendimin.

U shpall në Tiranë më datë 18. 12. 2019.

SEKRETARE

Ermira KTHUPI

GJYQTAR

Klodian KURUSHI

